



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni pranveror*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.13/2017

Prishtinë, më 27 shkurt 2018

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Teuta Haxhiu.

Mungoi: Miljana Nikoliq, Frashër Krasniqi, Mytahir Haskuka, Mirjeta Kalludra dhe Albulena Balaj Halimaj

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu-EUSR/EU, Albert Krasniqi-KDI dhe Gordana Subotic-Melbourne University.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

**Rend dite:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit,
2. Shqyrtimi i Peticioneve,
3. Të ndryshme.

**1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit**

**Kryetarja**, Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 7 shkurt 2018, u miratua pa vërejtje.

## 2. Shqyrtimi i Peticioneve

**Kryetarja**, tha se kemi dy peticione të cilat i ka shqyrtuar grupi punues, sa i përket petitionit që ka të bëjë me kandidatët e përzgjedhur për pozitën e Inspektorit Policorë, e njëjta është shqyrtuar edhe në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, ku ka qenë në Raportim Ministri për Punë të Brendshme, në atë mbledhje ka qenë prezent edhe anëtarja e Komisionit, Teuta Haxhiu, e cila do të njoftoj komisionin në pika të shkurtra se si qëndron puna lidhur me këtë çështje.

**Teuta Haxhiu**, tha se pasi ka marrë ftesën ka shkuar në mbledhje të Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së. Ka qenë e njëjta temë, ishin prezent mediat, por me insistim të ministrit mbledhja është mbajtur pa media, është diskutuar gjatë kjo temë, në fund kam kërkuar nga ministri të na dërgojë me shkrim një njoftim nga ana e ministrisë sepse ne si Komision për të Drejtat e Njeriut duhet me ju kthye një përgjigje parashtruesve të petitionit. Ata mohojnë se ka pasur shkelje të të drejtave.

Në atë takim është diskutuar më shumë se 2 orë për këtë çështje por, neve si komision na intereson vetëm aspekti i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe në këtë drejtim kisha lut administratën për të dërguar një shkresë ministrisë lidhur me këtë petition, se si qëndron çështja.

**Saranda Bogujevci**, pyeti se cilat kanë qenë arsyetimet nga ana e ministrit lidhur me këtë çështje.

**Teuta Haxhiu**, tha se ministri menjëherë ka kërkuar një auditim të brendshëm, auditori ishte prezent aty dhe i ka afër 27 shkelje që janë gjet dhe ato janë të natyrave të ndryshme.

Por neve si komision na interesojnë vetëm ato lidhur me aspektin e të drejtave të njeriut dhe për ato kërkojmë të na sjellin informatë me shkrim.

**Mexhide Mjaku-Topalli**, u interesua të dijë se nga takimi që ka pasur Komisioni për Punë të Brendshme, a është nxjerrë ndonjë përfundim apo konkluzion, lidhur me atë se, a ka qenë ministri kompetent me marrë një veprim të tillë apo jo, a ka shkelur ministri ndonjë ligj me këtë veprim.

**Teuta Haxhiu**, ne mundemi të kërkojmë nga ministri komplet një raport, por unë thash vetëm në aspektin e të drejtave të njeriut vetëm për çka jemi kompetent, sepse aty kishte shkelje të natyrave të ndryshme, takimi ishte i mbyllur.

**Lirije Kajtazi**, tha se po i presim këto shkresa sepse na duhet për të ditur me shumë para se të nxjerrim përfundim.

**Saranda Bogujevci**, propozoi që dikush nga anëtarët e këtij komisioni të merë pjesë në Grupin Punues të Komisionit për Punë të Brendshme.

**Kryetarja**, tha se ne tani po kërkojmë raportin me shkrim nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe më vonë edhe nga Komisioni për Punë të Brendshme do të njoftohemi, se çfarë veprime kanë ndërmarrë dhe pas shqyrtimit ne do ti njoftojmë palët.

Ajo më pas theksoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, ka formuar një grup punues që do të bëjë monitorimin e Ligjit për Inspektoratin Policor.

**Kryetarja**, në vazhdim tha se grupi punues ka shqyrtuar edhe peticionin e organizatave të dala nga Lufta të cilët kanë kërkuar mbajtje të seancës së jashtëzakonshme.

Lidhur me këtë peticion na ka ngarkuar Kryesia e Kuvendit me anë të një Përfundimi, të cilin e kemi shqyrtuar edhe në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2017.

Kryetarja paraqiti Përfundimin e Komisionit FunkSIONAL, si në vijim:

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjet e mbajtura më 14 shkurt dhe 27 shkurt 2018, shqyrtoi kërkesën e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, të ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit me Përfundimin nr. 06-P-021, datë 22.01.2018, dhe vendosi që Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

Kërkesa e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, nuk është e bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sipas nenin 69.4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi mblidhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të një të tretës së deputetëve të Kuvendit.

Komisionit FunkSIONAL miratoi Përfundimin e lartpërmendur.

### **3. Të ndryshme**

**Mexhide Mjaku-Topalli**, tha se sipas Planit të Punës, është monitorimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe për Barazi Gjinore, për këtë duhet të formohet grupi punuese dhe të fillojmë me punën.

Kryetarja, konstatoi se grupi punues do të formohet në mbledhjen e radhës së komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit*

Kryetarja e komisionit,

---

Duda Balje